

VENDIM
Nr.709, datë 18.6.2009

PËR MIRATIMIN E MANUALEVE TEKNIKE TË ÇMIMEVE TË PUNIMEVE TË
NDËRTIMIT DHE TË ANALIZAVE TEKNIKE TË TYRE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neni 18 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre, të rishikuara, sipas teksteve, që i bashkëlidhen këtij vendimi, që do të përdoren në përcaktimin e fondit limit të objekteve në sektorin e administratës publike.

2. Ministria e Financave të dërgojë të dhënat për çmimet mesatare të tregut të katër elementeve të strukturës së kostos, të nevojshme për përditësimin e çmimeve të manualit.

3. Çmimet e zërave të punimeve, të përcaktuara në manualet teknike, janë orientuese dhe referuese për planifikimin e buxhetit vjetor.

4. Mënyra e miratuar e analizës teknike të përdoret si bazë edhe për programin kompjuterik të llogaritjes së kostos nga shoqëritë sipërmarrëse.

5. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

6. Vendimi nr.1359, datë 10.10.2008 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha